



Pranuar / Dosturoar Punësimi / Prodato Received / Delivery	05 - 01 2024	4	viti god year
Organ / Shënjë Organ / Jednica Org / Unit	Ri / Prot B / Prot Prof / No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHICK 103/2024			1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1390/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca, anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses. sipas ankesës me numër A.nr.1390/2023 të datës 08.11.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 05.01.2024, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Kryetari i Komunës së Prishtinës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të shqyrtoj kërkesën e ankueses të datës 07.09.2023, lidhur me kompensimin për funksione shtesë si dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile (*tutje vetëm ankuesja*) me datë 08.11.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për mos kthimin e përgjigjes (nxjerrjen e vendimit) në lidhje me kërkesën Nr.14-120/01-0185875/23 të datës 07.09.2023 dhe kompensimin për funksione shtesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 05.01.2024, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6927/2023 të datës 08.11.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 07.09.2023 me numër të protokollit

14-120/01-0185875/23; Kërkesën për kompensimin e funksioneve shtesë me numër protokoll 14-120/01-185875/23 të datës 07.09.2023 të parashtruar nga ankuesja tek organi i punësimit; Vendimin me numër protokoll 14-020/04-162259/22 të datës 12.07.2022 lidhur me formimin e Komisionit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore; Vendimin me numër protokoll 14-020/04-198271/23 të datës 27.09.2023 lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër protokoll 14-020/04-162259/22 të datës 12.07.2022; Akt emërimit e ankueses me numër 01 nr.112-810 të datës 23.07.2019; Procesverbalet e datës 04.09.2023, 18.09.2023, 02.10.2023 të Komisionit për shitjen e banesave; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.11.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 05.01.2024 nga Komuna e Prishtinës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin me numër 14-030/01-72586/23 të datës 06.04.2023 lidhur me caktimin e Komisionit për Shitjen e Banesave; Procesverbalin e datës 10.03.2023 nga Komisioni për Shitjen e Banesave; Procesverbalin e datës 03.03.2023 nga Komisioni për Shitjen e Banesave; Procesverbalin e datës 13.03.2023 nga Komisioni për Shitjen e Banesave; Akt emërimit e ankueses me numër 01-nr.112-810 të datës 01.03.2017; Përshkrimin e detyrave të punës së ankueses; Kërkesën për kompensim material të orëve shtesë 06.02.2023 me numër 14-120/06-27687/23 të datës 06.02.2023; Kartelën e nëpunës-ankueses të datës 23.06.2023, Kërkesën e datës 21.06.2023 përmes e-mailit zyrtar nga KPMSHCK për informata zyrtare drejtuar Komunës së Prishtinës, Përgjigje në kërkesë nga organi i punësimit sipas emailit të datës 24.07.2023 si dhe Vendimin me numër protokoll 7557/2023 të datës 19.12.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi që lënda të kthehet në detyrim të organi i punësimit, me obligimin që Kryetari i Komunës së Prishtinës, të shqyrtoj kërkesën e ankueses lidhur me kompensimin për funksione shtesë si objekt i kësaj ankesë, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesja është e punësuar në Komunën e Prishtinës dhe se e njëjta sipas Aktit të Emërimit me numër 01 nr.112-810 të datës 23.07.2019, ushtron pozitën e punës Zyrtare e Pasurisë në Drejtorinë e Pronës.

Më tej nga shkresat e lëndës rezulton se Kryetari i Komunës së Prishtinës me Vendimin me numër protokoll 14-022/04-162259/22 të datës 12.07.2022 ka themeluar Komisionin për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, me ç' rast sipas këtij vendimi ankuesja është caktuar si kryesuese e komisionit për Shitjen e Banesave.

Ankuesja me datë 07.09.2023 i është drejtuar Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Ushtruesit të Detyrës së Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, me kërkesën për kompensimin e funksioneve sipas Vendimit me numër protokoll 14-022/04-162259/22 të datës 12.07.2022, dhe mbi bazën ligjore të nenit 38 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik si dhe nenit 5 e 7 të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, iu referua dispozitave e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht:

- nenit 83 me të cilin wshtw pwrctuar se: *Procedura administrative fillon sipas kërkesës të palës apo sipas detyrës zyrtare nga organi publik,*
- Nenit 97 paragrafit 1 më të cilin parashihet se: *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative,*
- dhe nenit 98 ku thuhet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj. 3. Nëse me ligj parashihet detyrimi i palës për të parashtruar një dokument apo për të kryer një veprim procedural, si pjesë apo së bashku me parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës, afati*



i përcaktuar në pajtim me paragrafin 1 ose 2 të këtij neni, do të fillojë të llogaritet nga parashtrimi i dokumentit apo kryerja e veprimit procedural përkatës.

Andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor dhe duke qenë se organi i punësimit në këtë rast Komuna e Prishtinës nuk ka shqyrtuar kërkesën e ankueses të datës 07.09.2023, lidhur me kompensimin për funksion shtesë përkitazi me angazhimin në Komisionin për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, rrjedhë detyrimi që Kryetari i Komunës së Prishtinës, brenda afatit të përcaktuar si në pikë I të dispozitivit të shqyrtoj kërkesën e ankueses të datës 07.09.2023 dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe të njëjtin t'ia komunikoj palës ankuese siç përcaktohet me nenin 118 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Theksuar si më sipër, e në kuptim të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1390/2023

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse



Ardita Hashmikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses;
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

